



AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT



BULETINI I PËRJAVSHËM

Java 7



Studentë dhe profesorë nga Venecia i bashkangjiten projektit të 'Via Egnatia'

35 studentë dhe profesorë të Universitetit të Venecia, sëbashku me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit kanë filluar marshimin në rrugën antike romake 'Via Egnatia'.

Kjo, në kuadër të projektit për vitalizimin dhe krijimin e një produkti turistik bazuar në këtë rrugë, që dikur lidhte orientin me perëndimin.





Ministri i Zhvillimit, Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me studentë të Universitetit të Venecias

Rruga Egnatia, një nga udhët më të vjetra në Ballkan do të shndërrohet në një produkt të mirëfilltë turistik.

Ministri Ahmetaj, i pranishëm në një aktivitet të organizuar nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit në sheshin pranë Teatrit Kombëtar i hapi rrugën një projekti të rëndësishëm bashkëpunimi me Universitetin e Venecias me qëllim shndërrimin e rrugës antike në një vlerë turistike për vendin tonë.

“Sot është një ditë mjaft e rëndësishme. Rruga Egnatia, një nga më antiket në Ballkan do të vizitohet nga profesor, studentë dhe eksplorues të Universitetit të Venecias.

Kjo do të jetë një pikënisje për kthimin e kësaj rruge në një atraksion turistik për vendin tonë”, tha Ahmetaj.





Ky udhëtim do të bëjë të mundur mbledhjen e informacioneve lokale, imazheve të pejsazheve historike, monumenteve të trashëgimisë kulturore si dhe shënime nga ky udhëtim, duke shpresuar se shumë shpejt Via Egnatia, e cila dikur lidhte Romën me Kostandinopojën, Orientin me Oksidentin, do të jetë një mundësi e madhe në zhvillimin e turizmit rural nëpërmjet udhëtimeve kulturore, shpirtërore, religjioze, artit, filozofisë, teatrit e kulinarisë.

Kjo do të ishte një tjetër mundësi që i shtohet mundësive të shumta të vendit tonë për të tërhequr sa më shumë vizitorë të huaj si dhe për ta parë këtë rast si një burim për ekonominë e vendit.





Momente të shkëputura gjatë marshimit në Via Egnatia





Momente të shkëputura gjatë marshimit në Via Egnatia

